



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Municipal Istog
Municipal Istog

Drejtoria për Arsim

05.Nr. 217/19
Datë: 18.04.2019

Drejtoria për Arsim në Komunën e Istogut dukë u bazuar në neni 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, neni 35 të Ligjit Nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.03/L-068 Për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës, dhe në mbështetje të: UA-MPMS, Nr.07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, UA-MASHT, nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, UA-MASHT, nr.02/2017 Për Vlefshmerinë e Programeve Studimore të Bartësve Privat të Arsimit të Lartë si dhe, references për aprovim të pozitive Nr.13-016-15638 të datës 17.04.2019 shpall këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Në IP "Gzimi Ynë" në Istog

1. Një Edukatore

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit),
- Çertifikata e lindjes
- Kopja e diplomës e vërtetuar, ose certifikata në vend të diplomës e vërtetuar jo me e vjeter së gjashtë muaj çdo certifikat me e vjeter së gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasyshë.
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jasht Republikës së Kosovës, duhet ti kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT (nëse ka)
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime ,
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim (nëse ka)

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-032) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr. 10/2018) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Sipas nenit 3 të UA-MASHT,Nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm për edukatore kërkohen këto kualifikime si në vijim:

- Fakulteti i edukimit-programi parashkollor;
- Shkolla e lartë Pedagogjike-drejtimi për edukatore
- Fakulteti Filozofik-dega e pedagogjisë së përgjithshme
- Fakulteti i Shkencave Sociale-programi përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve.

Afati i konkursit mbetet i hapur prej datës 18.04.2019 deri më datën 02.05.2019.

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra Nr.100,kati përdhësë dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin përcjellës po në të njëjten zyre.

Dokumentacioni duhet të jetë në kopje,Komisioni i pranimit në rast dyshimi do të kërkon origjinalin në intervistë. Ky dokumentacion shërben deri në përfundim të procedurës së konkursit i njëjti nuk kthehet dhe as nuk ruhet. Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili arrinë pas afatit nuk do të shqyrtohet gjithashtu kandidatët të cilët nuk e plotësojnë qartë dhe saktë formularin e aplikimit(kërkesën) do të refuzohet.

Në testin me shkrim do të ftohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriterët bazuar në aktet normative dhe legjislacionin në fuqi,kurse intervistes do ti nenshtrohen vetem kandidatët të cilët arrin të kenë me shumë së 50% të kalushmeris se testit më shkrim.

